



IOM International Organization for Migration
ONM Organizata Ndërkombëtare për Migracionin

PAKETË INFORMUESE PËR PORTUGALINË

1. Informacioni bazë

Kryeqyteti:	Lisbona
Popullsia:	10.6 milion
Sipërfaqja:	92 072 km ²
Monedha:	Euro
Niveli i papunësisë:	8% (2007)

2. Vizë për të vizituar Portugalinë- Informacion i përgjithshëm

Shtetasit kroatë nuk kanë nevojë të aplikojnë për vizë për qëndrim afatshkurtër (C). Shtetasit e Shqipërisë, Bosnjë Hercegovinës, ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë, Malit të Zi dhe Serbisë i nënshtrohen kërkesës për vizë. Bazuar në Marrëveshjet për Lehtësimin e Vizave dhe në Marrëveshjet e Ripranimit ndërmjet BE-së dhe Shqipërisë, Bosnjë Hercegovinës, ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë, Malit të Zi dhe Serbisë, shtetasit e këtyre vendeve duhet të kërkojnë vizë C Shengen për të hyrë në Portugali; megjithatë ata përfitojnë një tarifë të reduktuar vize (35 Euro në vend të 60 Euro). Shumë kategori të aplikantëve (familjarë të shtetasve rezidentë të ligjshëm, studentë dhe pensionistë, gazetarë etj) tani mund të marrin gjithashtu viza falas.

Për kategori të caktuara personash p.sh. tregtarë, studentë dhe gazetarë, kërkesat për dokumentacion do të thjeshtohen. Disa kategorive të personave që udhëtojnë shpesh (përfshirë këtu tregtarë, gazetarë, studentë, përfaqësuesi të shoqërisë civile) do t'u jepen viza me shumë hyrje për periudha të gjata vlefshmërie dhe mbajtësit e pasaportave diplomatike do të përjashtohen nga detyrimi për vizë.

Shihni hollësitë në:

<http://eur-lex.europa.eu/LexUriServ/LexUriServ.do?uri=OJ:L:2007:334:0085:0095:EN:PDF> (për Shqipërinë)

<http://eur-lex.europa.eu/LexUriServ/LexUriServ.do?uri=OJ:L:2007:334:0097:0107:EN:PDF> (për Bosnjë Hercegovinën)

<http://eur-lex.europa.eu/LexUriServ/LexUriServ.do?uri=OJ:L:2007:334:0125:0135:EN:PDF> (për ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë)

<http://eur-lex.europa.eu/LexUriServ/LexUriServ.do?uri=OJ:L:2007:334:0137:0147:EN:PDF> (për Serbinë)

<http://eur-lex.europa.eu/LexUriServ/LexUriServ.do?uri=OJ:L:2007:334:0109:0119:EN:PDF> (për Malin e Zi)

Për më shumë informacion dhe formularë aplikimi për vizë vizitoni Shërbimin për Kontrollin Kufitar dhe të Huajt) (*Serviço de Estrangeiros e Fronteiras* - SEF) në faqen e internetit

Kjo paketë informuese u përgatit në kuadër të projektit AENEAS 2006: Ndërtimi i Kapaciteteve, Informacion dhe Ndërgjegjësim për Promovimin e Migracionit të Rregullt në Ballkanin Perëndimor të financuar nga Bashkimi Europian dhe të bashkë-financuar nga Zyra Federale Zvicerane për Migracionin, Zyra Federale Gjermane për Migracionin dhe Refugjatët, Ministria Italiane e Punëve të Jashtme/Bashkëpunimi Italian për Zhvillim dhe Qeveria e Lihtenshtejn.



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra



Federal Office
for Migration
and Refugees



<http://www.sef.pt/portal/V10/EN/asp/apoiocliente/index.aspx>. Ose i kërkonit stafit të MSC t'ju japë informacionin e nevojshëm dhe formularët e aplikimit.

3. Imigracioni për Qëllime Punësimi

Lejet e punës

Leja e punës mundëson hyrjen tuaj në Portugali me qëllim kryerjen përkohësisht të një veprimtarie profesionale, i punësuar apo jo. Kjo lloj vize mund të jepet për të mundësuar qëndrimin tuaj në Portugali për perioda deri në një vit.

Ekzistojnë llojet e mëposhtme të lejeve të punës:

- Leje e punës I- për të kryer veprimtari profesionale brenda fushës së sportit apo argëtimit
- Lejet e punës II- për të kryer veprimtari profesionale që përfshin kërkimin shkencor ose që prezumon njohuri teknike tepër të kualifikuara, që në secilin rast mund të verifikohen nga dega përkatëse e administratës publike
- Leje e punës III- për të kryer një veprimtari të pavarur profesionale me qëllim ofrimin e një shërbimi profesional
- Leje e punës IV- për të kryer veprimtari profesionale punësimi

Në disa raste të mirë justifikuar, vizat për qëndrim të përkohshëm lejojnë mbajtësin e tyre të kryejë një veprimtari profesionale njësoj si ata që kanë një leje pune. Autoriteti për lëshimin e lejeve të punës jashtë Portugalisë është Ambasada përkatëse e Portugalisë, ndërsa Shërbimi për Kontrollin Kufitar dhe të Huajt është përgjegjës për këto çështje në Portugali.

Për më shumë informacion shihni në faqen e internetit:

<http://www.sef.pt/portal/V10/EN/asp/apoiocliente/index.aspx>.

4. Studime në Portugali

Një vizë për studime në Portugali mundëson hyrjen tuaj në Portugali për të ndjekur një program studimi në një institucion arsimor të njohur zyrtarisht; për të kryer kërkim shkencor si pjesë e një diplome akademike ose një kërkim me interes shkencor për një institucion arsimor të njohur zyrtarisht; për të kryer praktikën për përfundimin e studimeve jashtë ose në këtë vend; dhe për të kryer praktikën në kompani, Shërbim Civil apo qendra trajnimi që nuk konsiderohen institucione arsimore zyrtare. Kjo vizë mund të jepet për të mundësuar qëndrimin në Portugali për periudhën deri në një vit. Një student mund të ushtrojë veprimtarinë e tij/saj në formë plotësuese, ndërsa ai/ajo realizon me sukses qëllimin për të cilin është lëshuar viza.

Informacion për bursë studimi në Portugali mund të gjendet në: <http://www.fae.pt/menu.htm>, <http://www.cnedu.pt/engcnems.htm> (të dyja faqet e internetit kanë variantin në anglisht).

Lista e universiteteve kryesore

Universidade de Coimbra (Coimbra): <http://www.ci.uc.pt/english/>

Universidade de Évora (Évora) <http://www.uevora.pt/?lang=eng&lang=eng>

Universidade de Lisboa (Lisbon)

http://www.ul.pt/portal/page?_pageid=173,1&_dad=portal&_schema=PORTAL

Universidade da Madeira (Madeira)

http://www.uma.pt/portal/modulos/noticia/index.php?NV_MOD=MODNOTICIA&NV_EAGR=EAGR_NOTICIA_BROESER&TPESQ=PESQ_NOTICIA_DESTAQUES&IDM=EN

Universidade Nova de Lisboa (Lisbon) http://www.unl.pt/index.html?set_language=en&cl=en

Universidade do Porto (Porto) http://sigarra.up.pt/up_uk/WEB_PAGE.INICIAL

Universidade Técnica de Lisboa (Lisbon) <http://www.utl.pt/>

Universidade Autónoma de Lisboa (Lisbon) <http://www.universidade-autonoma.pt/default.aspx?lg=EN>

Universidade Católica Portuguesa (Braga, Lisbon Figueira da Foz, Porto dhe Viseu)

<http://www.ucp.pt/site/custom/template/ucptplportalhome.asp?sspageid=1&lang=2>

Universidade Fernando Pessoa (Porto) <http://www.ufp.pt/page.php?intPageObjId=13332>

5. Qëndrimi

Një vizë qëndrimi ju lejon të hyni në Portugali me synim për të aplikuar për një lejë qëndrimi. Kjo vizë qëndrimi lejon që mbajtësi i saj të qëndrojë në Portugali për gjashtë muaj. Megjithatë, personat që aplikojnë duhet të marrin parasysh që dikush që ka një vizë qëndrimi nuk konsiderohet akoma rezident, por vetëm autorizohet për të aplikuar për leje qëndrimi. Shërbimi për Kontrollin Kufitar dhe të Huajt është autoriteti përgjegjës që jep autorizimin për të qëndruar. Në shqyrtimin e një kërkesë për një vizë qëndrimi, kriteret e mëposhtme do të merren parasysh:

- arsyeja pse kërkohet qëndrimi dhe mundësitë e suksesit, për shembull, bashkim familjar (aplikanti duhet të paraqesë një deklaratë që përmban arsyet për kërkesën);
- mjetet e jetesës që ka aplikanti për të jetuar në këtë vend (në lidhje me mënyrat sesi mund të provohet kjo gjë, personi duhet të konsultohet me Vendimin Rregullues (*Decreto Regulamentar*) Nr 9/2001, 31 maj, që mund të gjendet në www.acime.gov.pt) dhe;
- kushtet e akomodimit.

Për më shumë informacion ju lutem kontaktoni: faqen e internetit të Komisionerit të Lartë për Imigracionin dhe Pakicat Etnike në www.acime.gov.pt, dhe faqen e internetit të *Serviço de Estrangeiros e Fronteiras* në: <http://www.sef.pt/portal/V10/EN/asp/apoiocliente/index.aspx>

6. Azilkërkues dhe refugjatë

Sipas Kushtetutës së Portugalisë, azili u jepet të huajve dhe personave pa shtetësi të përndjekur ose të kërcënuar rëndë për shkak të veprimtarive të tyre në favor të demokracisë, lirive sociale apo kombëtare, paqes ndërmjet popujve, lirisë dhe të drejtave të njeriut, apo racës, fesë, kombësisë, opinionit politik, apo anëtarësisë në grup politik apo social në Shtetin e tyre, ose shtetasve që kanë frikë të argumentuar se mund të përndiqen.

Ligji portugez për azilin parashikon dy situata të mbrojtjes: statusin e refugjatit, mbrojtjen për arsye humanitare. Për procedurën e azilit ka dy faza, vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës dhe dhënia e statusit të refugjatit ose dhënia e lejeve të qëndrimit për arsye humanitare pas vlerësimit të pranueshmërisë.

Për procedurën e aplikimit për azil shihni: <http://www.sef.pt/portal/V10/EN/asp/apoiocliente/index.aspx>, Ose pyesni stafin e MSC.

7. Bashkimi familjar

Për një imigrant që ka pasur leje qëndrimi për të paktën një vit, legjislacioni portugez jep të drejtën për bashkim familjar me anëtarët e familjes që jetojnë jashtë Portugalisë - dhe, në raste të veçanta, atyre që ndodhen në Portugali- dhe atyre që kanë jetuar me ju në një vend tjetër ose që janë në ngarkimin tuaj.

Një vizë qëndrimi do t'ju jepet anëtarëve të familjes kur të kenë dorëzuar informacion përkatës për të aplikuar për leje qëndrimi. Një anëtar i familjes do të pajisjet me vizë qëndrimi të vlefshme për dy vjet. Si në situatën e një leje qëndrimi të përkohshëm dhe të përhershëm, pas mbarimit të dy viteve që nga dhënia e lejes së parë dhe me kusht që të jenë ruajtur lidhjet familjare, anëtarët e familjes do të kenë të drejtën e tyre të pavarur për leje qëndrimi.

Kërkesa për bashkim familjar duhet të paraqitet në degën rajonale të Shërbimit për Kontrollin Kufitar dhe të Huajt në zonën ku banon aplikanti. Për më shumë informacion për dokumente të nevojshme shihni: <http://www.sef.pt/portal/V10/EN/asp/apoiocliente/index.aspx#0>.

8. Sistemi i Kujdesit Shëndetësor

Të gjithë imigrantët që janë në Portugali dhe janë të sëmurë apo kanë nevojë për kujdes shëndetësor, kanë të drejtë të trajtohen në Qendër Shëndetësore apo Spital (për raste urgjente) dhe nuk ekziston mundësia e refuzimit të këtyre shërbimeve për t'i trajtuar bazuar në çdo arsye që lidhet me kombësinë, mungesën e mjeteve ekonomike, mungesën e statusit ligjor apo arsye të tjera.

Kujdesi shëndetësor i ofruar nga Shërbimi Shëndetësor Kombëtar (SNS) përfshin kujdesin në lidhje me forcimin e kujdesit shëndetësor dhe parandalimit të sëmundjeve; kujdesin shëndetësor për praktikën e përgjithshme dhe specializimin; kujdesin e infermierisë; shtrimin në spital; teste diagnostikuese fakultative; mjekim dhe produkte mjekësore; dhe gjymtyrëve artificiale dhe pajisje të tjera terapeutike.

Karta e Shëndetit është dokument që verifikon identitetin e mbajtësit të saj tek organet dhe shërbimet që janë pjesë e Shërbimit Shëndetësor Kombëtar. Kjo kartë jepet falas. Duhet të tregohet për trajtimin e kujdesit shëndetësor, për të caktuar një vizitë tek doktori dhe shërbime të tjera shtesë diagnostikuese dhe terapeutike dhe për përshkrimin dhe marrjen e mjekimit. Për të marrë një Kartë të Shërbimit Shëndetësor Kombëtar, shtetasit e huaj duhet të tregojnë dokumentacion që vërteton statusin e tyre të qëndrimit ose lejen për statusin e qëndrimit në qendrën e shëndetit në zonën e banimit të tyre ose një leje pune që i autorizon të punojnë në Portugali. Të gjithë individët duhet të regjistrohen dhe të kenë një Kartë Shëndeti dhe kjo mund të merret tek Qendra e Shëndetit ose në një Zyrë për Qytetarin (Loja do Cidadão).

Për informacion të hollësishëm për kujdesin shëndetësor për imigrantët në Portugali shihni faqen e internetit të Komisionerit të Lartë për Emigracionin dhe Pakicat Etnike:

http://www.acime.gov.pt/modules.php?name=FAQ&myfaq=yes&id_cat=19&categories=Health+Guide+for+Imigrants.

9. Sistemi i Sigurimeve Shoqërore

Komisioni i Përgjithshëm për Sigurimet Shoqërore (*Direcção-Geral da Segurança Social – DGSS*) është përgjegjës për sistemin e sigurimeve shoqërore në Portugali. Sipas legjislacionit portugez, refugjatët, personat pa shtetësi dhe të huajt që qëndrojnë në Portugali mbrohen nga skema jo-kontribuese e sigurimeve shoqërore meqë nuk mbulohen nga skema e sigurimeve shoqërore me kontribut të detyrueshëm.

Përfitimi nga kjo skemë varen nga realizimi e një kontrolli të mjeteve financiare, pra kërkuesi duhet të vërtetojë që të ardhurat e tij/saj nuk kalojnë shumën e përcaktuar me ligj. Përfitimet e mëposhtme jepen në kesh:

- Përfitimi familjar për fëmijët dhe të rinjtë- ndihmë mujore për të kompensuar shpenzimet familjare që bëhen për arsimimin e fëmijëve dhe të rinjve
- Përfitim unik të pataksuar për funeral për të kompensuar kërkuesin për shpenzimet e bëra për funeralin e një anëtari të familjes ose personi tjetër që qëndron në territorin shtetëror. Përfituesve të kësaj skeme u garantohet pagesa e një pensioni për bashkëshortin/bashkëshorten e marrësit të pensionit social, pension për fëmijët dhe të rinjtë derisa të arrijnë moshën madhore, apo emancipimin nëse janë jetimë nga prindër që nuk mbulohen nga ndonjë skemë e sigurimeve shoqërore.

Për informacion të mëtejshëm, shih faqen e internetit të DGSS: <http://www.seg-social.pt/>

10. Strehimi

Në Portugali, strukturat vendore si bashkitë dhe komunat kanë përgjegjësi administrative dhe financiare mbi komunitetet e tyre dhe administrojnë një sërë shërbimesh vendore dhe interesa kolektive siç janë shkollat elementare dhe strehimi social. Bashkitë vendore, sidomos Zona Metropolitane e Lisbonës, filloi fushatë në nivel vendor për Programin Special të Ri-strehimit për pakicat etnike dhe emigrantët.

Për nisma private:

Shërbimi i Apartamenteve në Lisbonë: <http://www.arc-corporate-housing.com/city/corporate-housing-Lisbon.html>.

Apartamente në Lisbonë: <http://www.lisbon-apartments.com/>

11. Njohja e diplomave dhe gradave të huaja

Njohja e diplomave të migrantëve në Portugali po kalon nëpër ndryshime të rëndësishme. Institucioni përgjegjës për procesin e njohjes së diplomave në Portugali është Komisioneri i Lartë për Emigracionin dhe Pakicat Etnike. Për më shumë informacion shihni faqen e internetit: <http://www.acime.gov.pt/modules.php?name=Content&pa=showpage&pid=103>.

Informacion për procesin mund të merret në Sistemin Kombëtar të Mbështetjes së Imigrantëve që ndodhet në Lisbonë dhe Porto (shtetas) me Qendrat e tij Vendore për Mbështetjen e Imigrantëve (CLAII) të vendosur në ndërtesat e Bashkive- Bashkive të qytetit, Këshillave Komunalë – apo OJQ-ve, që kanë një zyrë të vogël të drejtuar nga një ndërmjetës i vendit pritës dhe të pajisur me kompjuter që ka akses në Rrjetin Kombëtar të Informacionit për Imigrantët dhe me një telefon.

12. Shërbime mbështetëse për migrantët

Qendra Kombëtare e Mbështetjes së Imigrantëve është *one-stop shop* për imigrantët që jetojnë në Portugali dhe bashkon në të njëjtën hapësirë disa zyra të ndryshme të qeverisë dhe të mbështetjes. Stafi MSC do t'ju japë broshurën NISC.

Rrjeti Kombëtar për Informacionin për Imigrantët (NIIN) në veçanti u jep informacion për nivelin kombëtar shtetasve imigrantë dhe, nga ana tjetër, në përgjithësi shoqërisë portugeze të interesuar për çështjen e imigracionit. Brenda fushës së veprimtarisë së NIIN, në linjën **SOS IMMIGRANT LINE-(LINJA SOS PËR IMIGRANTËT)**, një shërbim telefonik për të ndihmuar Imigrantët dhe institucionet që punojnë me Imigrantët, i cili siguron informacion të përgjithshëm për problemet e imigracionit dhe që do të përgatitet specifikisht për të dhënë këshilla brenda kuadrit të situatave të rënda (p.sh. përpjekje për integritetin fizik të personit, situata të abuzimit në punë, të abuzimit me strehimin ose qëndrime për diskriminimin) dhe i cili është në dispozicion në tre gjuhët zyrtare (portugalisht, anglisht dhe rusisht). Numrat e kontaktit janë: **808 257 257 / 21 8106191**.

Për më shumë informacion shihni:

<http://www.acime.gov.pt/modules.php?name=Content&pa=showpage&pid=112>.

Informacion për numrin e madh të Shoqatave të Imigrantëve që ekzistojnë në Portugali mund të gjeni në:

<http://www.acime.gov.pt/modules.php?name=Content&pa=showpage&pid=117>.

Për më shumë informacion për çështje të imigrantëve mund të kontaktoni Shërbimin për Kontrollin Kufitar dhe të Huajt: <http://www.sef.pt/portal/V10/EN/asp/page.aspx>, ose faqen e internetit të Komisionerit të Lartë për Emigracion dhe Pakica Etnike:

http://www.acime.gov.pt/modules.php?name=FAQ&myfaq=yes&id_cat=19&categories=Health+Guide+for+Imigrants.

13. Shtetësia

Shtetësia portugeze mund të merret nëpërmjet vendimeve të ndërgjegjshme nga fëmijë të mitur ose me të meta fizike të një mamaje apo babai që ka fituar shtetësinë portugeze në rastin e martesës me një shtetas portugez, nëpërmjet adoptimit dhe nëpërmjet natyralizimit që jepet nga Sekretari i Brendshëm pas kërkesës nga pala e interesuar.

Legjislacioni portugez e lejon dyshtetësinë. Një fëmijë i prindërve imigrantë mund të marrë shtetësi portugeze nëse lind në territorin portugez; nëse prindërit kanë një leje të vlefshme qëndrimi dhe janë

rezidentë në Portugali për 6 ose 10 vjet, ose paraqesin një deklaratë që pohon dëshirën për t'u bërë portugezë.

Kërkesa për shtetësi së bashku me dokumentet e nevojshme duhet t'i paraqiten Degëve Rajonale të Shërbimit për Kontrollin Kufitar dhe të Huajt, ose në rast se nuk ekziston një i tillë, Guvernatorit Civil në zonën e banimit, ose shërbimit konsullor nëse jeni jashtë Portugalisë, ose Zyrës Qendrore të Regjistrimit në rast se është fituar shtetësia portugeze nëpërmjet martesës.

14. Zyra e qeverisë përgjegjëse për imigracionin

Ambasada në Shqipëri

(Ambasada në Romë)

Ambasada në Bosnjë Hercegovinë

Cobanija 12/1

71000 Sarajevo

Tel: +387-200-835

Email: embaport@bih.net

Ambasada në Kroaci

Trg Bana Jelacica 5 / II kat

10 000 Zagrebe

Tel: (003851) 488 2210 / 1

E-mail: emb.port.zagreb@zg.htnet.hr

Ambasada në Maqedoni

(Ambasada në Serbi)

Ambasada në Serbi

Vladimira Gacinovica 4

11040 Beograd

Tel: (38111) 266 28 95/71 Shërbimi konsullor: (38111) 266 28 94

E-Mail: portugalamb@sbb.co.yu

Shërbimi për Kontrollin Kufitar dhe të Huajt (Serviço de Estrangeiros e Fronteiras - SEF):

<http://www.sef.pt/portal/V10/EN/asp/ajpoicliente/index.aspx>.

Komisioneri i Lartë për Imigracionin dhe Pakicat Etnike: www.acime.gov.pt